

REKOMANDIMI NR.R (2000) 2

I KOMITETIT TË MINISTRAVE PËR SHTETET ANËTARE LIDHUR ME RISHQYRTIMIN OSE RIHAPJEN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË CAKTUARA NË NIVEL TË BRENDSHËM, MBËSHTETUR NË VENDIMET E GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT¹¹

(Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 19 janar 2000, gjatë takimit të 694)

Komiteti i Ministrave, në përputhje me parashikimet e nenit 15.b të Statutit të Këshillit të Europës,

Duke pasur parasysh se qëllimi i Këshillit të Europës është arritja e një uniteti më të ngushtë ndërmjet anëtarëve të tij;

Duke pasur në vëmendje Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (këtej e më tutje referuar si "Konventa");

Duke ditur se sipas nenit 46 të Konventës për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore ("Konventa"), palët kontraktuese kanë pranuar detyrimin për t'iu bindur vendimeve përfundimtare të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut ("Gjykata") për cilëndo çështje, në të cilën ato janë palë, dhe se Komiteti i Ministrave do të mbikëqyrë zbatimin e tyre;

Duke pasur në vëmendje se në rrethana të caktuara detyrimi i sipërpërmendur mund të kërkojë miratimin e masave, përveç atyre të shpërblimit të drejtë të caktuar nga Gjykata në përputhje me nenin 41 të Konventës dhe/ose masa të përgjithshme, të cilat sigurojnë se pala e dëmtuar vendoset, aq sa është e mundur, në të njëjtën situatë në të cilën ai ose ajo ishin përpara shkeljes së Konventës (*restituito in integrum*);

Duke vërejtur se janë autoritetet kompetente të shtetit të paditur ato që vendosin se çfarë masash janë më të përshtatshme për të arritur *restituito in integrum*, duke marrë në konsideratë mjetet që njihen sipas sistemit ligjor kombëtar;

Duke pasur në mendje se eksperiencia në mbikëqyrjen e zbatimit të vendimeve të Gjykatës nga ana e Komitetit të Ministrave tregon se në rrethana të jashtëzakonshme rishqyrtimi i një çështjeje ose rihapja e procedimeve ka rezultuar se është mjeti më efikas, nëse nuk është i vetmi, i arritjes së *restituito in integrum*;

Fton palët kontraktuese që, duke pasur në vëmendje sa u parashtrua më sipër, të sigurojnë se në nivel kombëtar ekzistojnë mundësi të mjaftueshme për të realizuar, sa më gjerë të jetë e mundur, *restituito in integrum*;

Inkurajon palët kontraktuese, në veçanti të shqyrtojnë sistemet e tyre ligjore kombëtare, me synimin e garantimit të ekzistencës së mundësive të mjaftueshme për rishqyrtimin e një çështjeje, përfshi edhe rihapjen e procedimeve, në ato faza ku gjykata konstaton shkelje të Konventës, veçanërisht kur:

i) Pala e dëmtuar vazhdon të vuajë pasojat tepër negative, të cilat janë rezultat i vendimit që ankimohet, të cilat nuk janë korrigjuar në mënyrë të mjaftueshme nga shpërblimi i drejtë dhe nuk mund të ndreqen veçse nëpërmjet rishqyrtimit ose rihapjes dhe

ii) Vendimi i Gjykatës të çon në konkluzionin se:

a) vendimi i brendshëm i ankimuar është në themel në kundërshtim me Konventën ose

b) shkelja e konstatuar është mbështetur në gabime procedurale ose mangësi të tilla të rënda, që vënë në dyshim serioz rezultatin e procedurave të brendshme të ankimuara.

¹¹ Duke pasur në konsideratë se funksionet gjyqësore të Komitetit të Ministrave sipas nenit 32 të mëparshëm të Konventës do të pushojnë së shpejti, asnjë referim nuk është bërë për vendimet e Komitetit të Ministrave. Në çdo rast, është e kuptueshme se parimet e këtij rekomandimi do të zbatohen edhe për çështje të caktuara që mund të jenë akoma në shqyrtim në kohën e miratimit të këtij rekomandimi.